

AL



Aria

SISTEM MONITORIMI I GLICEMISË
PËR PËRDORIM NË SHTËPI DHE NË REPARTE SPITALORE



Leximi
i lehtësuar



3 lloje
kampionësh



Metoda



Mënyra
e testimit



Lehtësi
përdorimi



Ndriçim
prapa shfaqja



6 alarme



Ejektor



Të
personalizuara
vargjet



1. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TEKNIKE TË PRODUKTIT

2. PËRDORIMI I PRODUKTIT

3. MËNYRA E AKSESIT NË SHËRBIMIN E ASISTENCËS

4. DISPOZITA PËR ASGJËSIMIN E DUHUR

Metoda

GDH
FAD3 lloje
kampionëshLeximi
i lehtësuar

“Aria” është një **sistem monitorimi i glicemisë** për përdorim në shtëpi dhe në reparte spitalore.

Falë funksionimit me **teknologjinë me enzimën GDH-FAD**, “Aria” nuk lejon që saktësia e matjes të ndikohet nga ndryshimet e oksigjenit në gjak dhe nga ndërhyrja e maltozës dhe galaktozës.

ARIA mundëson analizimin e **3 lloje kampionësh**:


- Gjak venoz
- Gjak arterial
- Gjak kapilar

Mekanizmi nxjerrës i shiritit, thelbësor për të shmangur kontaminimet, e bën të përshtatshëm për përdorim spitalor.

LEXIM MË I LEHTË I REZULTATEVE FALË KODEVE ME NGJYRA

Rezultati i analizës së glukozës përkthehet në një **kod me ngjyrë** që lehtëson leximin dhe interpretimin e tij: kjo e bën instrumentin veçanërisht **efikas dhe të thjeshtë për t’u përdorur**. Studimet klinike tregojnë se:

- në krahasim me menaxhimin me BGM pa kode me ngjyra, menaxhimi i diabetit me instrumente që kanë kode me ngjyra përmirëson vlerën e hemoglobinës së glikuar;
- informacioni i dhënë nga kodi me ngjyrë ndihmon përdoruesin t’i interpretojë rezultatet. Kjo është shumë e dobishme veçanërisht për personat me akses të kufizuar në kura mjekësore dhe në ndërveprim të drejtpërdrejtë me profesionistët e shëndetit.



Pasi instrumenti të ketë kryer matjen, rezultati i testit të glicemisë do të shfaqet në ekran bashkë me datën, orën dhe njësinë matëse. Shigjeta te vizat me ngjyra do të tregojë statusin e vlerës së glicemisë, që mund të jetë “E ulët”, “Normale” dhe “E lartë”. Për të menaxhuar më shpejt vlerat glicemike, mund të vendoset intervali ideal i niveleve të glukozës në gjak duke e personalizuar sipas vlerave individuale dhe sugjerimeve të mjekut.

KARAKTERISTIKAT



Ekran me ndriçim të pasmë

Ekran me shkronja të mëdha, i gjerë dhe i ndriçuar për t'i lexuar më lehtë matjet edhe në ndriçim të dobët.



Modalitet i testit esëll/jo esëll

Për të menaxhuar më mirë të dhënat e përfuara, para matjes mund të dallohen rezultatet duke përdorur simbolin e mollës së plotë (esëll) ose atë të mollës së ngrënë (jo esëll).



Nxjerrje e sigurt e shiritit

Instrumenti është i pajisur me një mekanizëm nxjerrës që eliminon shiritin e përdorur, pa qenë nevoja të preket me dorë dhe duke shmangur kështu çfarëdolloj kontaminimi.



Lehtësi përdorimi

Rezultatet paraqiten në mënyrë intuitive falë ekranit me ndriçim të pasmë dhe kodeve me ngjyrë



6 alarme

Mund të konfigurohen deri në gjashtë alarme që kujtojnë se duhen kryer matjet

2.

PËRDORIMI I PRODUKTIT



1

Kryerja e testit të glicemisë:

Lani duart dhe vendin e marrjes së kampionit me ujë të ngrohtë dhe sapun. Shpëlajini dhe thajini me kujdes. Ngrohni gishtat për të rritur fluksin.


2

Merrni një shirit të ri reaktiv nga flakoni dhe, pasi ta keni marrë, sigurohuni që ta mbyllni hermetikisht flakonin. Fundin e shiritit me viza të zeza kontakti futeni te foleja e sipërme e instrumentit dhe sigurohuni që pjesa ngjyrë blu të jetë kthyer nga përdoruesi. Shtyni shiritin reaktiv deri në fund pa e përthyer. Instrumenti do të ndizet automatikisht duke lëshuar një sinjal akustik (nëse cilësimi i sinjalit akustik është aktivizuar).



Shtypni butonin "+" ose "-" për të kaluar nga modaliteti "Esëll" në modalitetin "Jo esëll".


VINI RE: Nëse gjaku nuk vendoset brenda 3 minutave, instrumenti do të fiket dhe për ta rindezur duhet futur përsëri shiriti.

**3**

Kryerja e injeksionit dixhital: mbështetni fort te mollëza e gishtit pajisjen e shpimit të gishtit që keni përgatitur paraprkisht. Shtypni butonin e lëshimit.

4

Për të marrë një kampion gjaku me vëllimin e nevojshëm për testin (0,5 µL gjak), masazhoni lehtë gishtin ose vendin e injektimit, pa ushtruar shumë forcë. Për një rezultat më të saktë, mos përdorni pikën e parë të gjakut, por shtypni lehtë gishtin për të marrë një pikë tjetër.



Gabim

Drejte

PARALAJMËRIM: mos e përhapni gjakun në vendin e injektimit, por përpquni të shtrydhni një pikë të plotë gjaku, siç tregohet në figurë. Nëse gjaku përhapet ose kullon te gishtin, pastrojeni, shtypni vendin e injektimit dhe përpquni të nxirrni një pikë të rrumbullakët gjaku. Kryejeni testin menjëherë pasi të keni marrë kampionin.

5


Vendosja e një kampioni gjaku. Kur në ekran shfaqet simboli i pikës "💧", vendosni kampionin e gjakut në fund të kanalit thithës të shiritit reaktiv; kampionin do ta thithë vet shiriti. Mbani majën e shiritit reaktiv në kontakt me pikën e gjakut derisa të mbushet plotësisht dritarja e konfirmimit dhe instrumenti të lëshojë një sinjal akustik (nëse cilësimi i sinjalit akustik është aktivizuar).






PARALAJMËRIM: mos e vendosni kampionin e gjakut mbi shiritin reaktiv. Mos e hiqni shiritin gjatë matjes derisa të shfaqet rezultati.

6


Leximi i rezultateve të testit kryhet pasi instrumenti numëron mbrapsht nga 5 deri në 1 dhe lëshon një sinjal akustik (nëse cilësimi i sinjalit akustik është aktivizuar): në këtë moment, rezultati i testit të glicemisë do të shfaqet në ekran bashkë me datën, orën dhe njësinë matëse. Shigjeta te vizat me ngjyra tregon statusin e vlerës së glicemisë, që mund të jetë "E ulët", "Normale" dhe "E lartë".



	E ulët:	0~70 mg/dL (0,0~3,8 mmol/L)*
	Normale:	71~180 mg/dL (3,9~10,0 mmol/L)*
	E lartë:	181~700 mg/dL (10,1~38,8 mmol/L)*

* Vlera e paracaktuar.

PARALAJMËRIME: Verifikoni që njësia matëse të jetë mg/dL. Mos merrni asnjë vendim për trajtim duke u bazuar te funksioni i treguesit të intervalit. Vendimet për trajtim duhen marrë pasi të konsultoheni me mjekun dhe jo duke u bazuar te vlerat e rezultateve në krahasim me kufijtë e intervalit.



7

Si të fikni instrumentin: rezultati i përftuar i glicemisë do të ruhet automatikisht në memorien e instrumentit. Fikni instrumentin duke hequr shiritin reaktiv me një shtypje të vogël te mekanizmi nxjerrës. Për të shmangur kontaminimet, asgjësojeni me kujdes shiritin e përdorur reaktiv.

3.

MËNYRA E AKSESIT NË SHËRBIMIN E ASISTENCËS

PACIENTËT:



Kujdesi ndaj klientit për pacientët do të menaxhojë kërkesat vijuese për informacion:

- kërkesa për informacione lidhur me pajisjet (modalitetet e përdorimit të sistemeve për matjen e glicemisë, modalitetet e ruajtjes së materialit për kryerjen e testeve etj.);
- kërkesa për ndërhyrje (edhe kërkesat për zëvendësimin e pajisjeve të prishura, që nuk funksionojnë mirë etj.). Gjithashtu, në përgjithësi, do të menaxhojë çdo kërkesë në mbështetje të përdorimit optimal të sistemeve, kërkesat për zgjidhjen e problemeve dhe për aktivizimin e procedurës së mirëmbajtjes apo zëvendësimit të pajisjes.

Kujdesi ndaj klientit për pacientët do të jetë aktiv për të pranuar kërkesat e ndërhyrjes dhe për dhënie informacioni çdo ditë të vitit, përfshirë të shtunat, të dielat dhe ditët e festave, në oraret që tregohen më poshtë:

Nga e hëna në të premte, ora 8:30 deri në 19:30 (11 orë)

Të shtunën, ora 8:30 deri në 17:30 (9 orë)

Të dielën/gjatë ditëve të festave, ora 8:30 deri në 17:30 (9 orë)

Kur Kujdesi ndaj klientit nuk është aktiv, pacientët mund të regjistrojnë një mesazh në sekretari dhe do të rikontaktohen sapo shërbimi të jetë aktiv.



MATËSI: meqë bëhet fjalë për një pajisje që mbulohet nga direktivat **përmbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike** që prodhohen për përdorim shtëpiak, ai duhet asgjësuar në **qendrat e grumbullimit** të autorizuara të komunës së rezidencës.

BATERITË: Bateritë nuk duhen hedhur kurrë me mbetjet urbane, por duhen asgjësuar veçmas **duke i çuar në pikat e grumbullimit që gjenden në qytet, në dyqane të autorizuara ose drejtpërdrejt në qendra grumbullimi.**

SHIRITAT: nëse në komunën e rezidencës nuk ka udhëzime specifike, këshillohet ta hiqni me kujdes shiritin reaktiv të përdorur nga instrumenti, ta grumbulloni bashkë me të tjerët në një enë të mbyllur hermetikisht për të shmangur rrezikun e kontaminimit dhe, kur ena të jetë mbushur, ta asgjësoni me mbetjet e padiferencuara. Në çdo rast, për asgjësimin e mbetjeve referojuni gjithmonë udhëzimeve të komunës suaj.



Biochemical Systems International S.p.A.

Loc. Palazzo Del Pero, 23 - 52100 Arezzo (AR) - Italy

Tel. +39 0575984164 - www.biosys.it

P.IVA 01736580513

